V E N D I M
Nr.523, datë 1.8.2003

PËR NJOHJEN DHE EKUIVALENTIMIN E DIPLOMAVE DHE TË CERTIFIKATAVE, TË FITUARA NË SHKOLLAT E LARTA, TË HUAJA

(Ndryshuar me VKM nr.187, datë 29.3.2006)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushetutës dhe të nenit 43 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Njohjen e diplomave dhe të certifikatave të fituara në shkollat e larta, të huaja, nga shtetas shqiptarë dhe të huaj.

2. Njohja akademike e diplomave dhe certifikatave, të fituara në shkollat e larta, të huaja, nga shtetas shqiptarë dhe të huaj, të jetë:

a) e drejtpërdrejtë, kur ato janë të vendosura me emërtim për njohje të ndërsjellë, në marrëveshje dypalëshe të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë me vendet e tjera;

b) e ekuivalentuar, kur ato nuk janë të përfshira me emërtim në marrëveshje ndërqeveritare dhe nuk kanë nevojë për plotësim diference, sipas shkronjës "c" të këtij neni;

c) me plotësim diferencash, të verifikuara.

3. Njohja akademike e diplomave dhe certifikatave të fituara në shkollat e larta, të huaja, nga shtetas shqiptarë dhe të huaj, të bëhet nga komisione ad-hoc, të caktuara me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, në përbërje të të cilave të jenë juristë dhe specialistë të fushës.

Nga ky rregull përjashtohen rastet kur ka marrëveshje ndërqeveritare apo dypalëshe, në fushën e arsimit dhe shkencës dhe rastet kur paraqiten nga i njëjti shtet, tituj diplomash të njohura më parë nga komisionet. Njohja në këto raste të jetë e drejtpërdrejtë.

4. Kriteret dhe procedurat për njohjen e diplomave dhe të certifikatave, të fituara në shkollat e larta, të huaja, nga shtetas shqiptarë dhe të huaj dhe veprimtaria e këtyre komisioneve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës.

5. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
FATOS NANO